

ARRITJET E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT NË BASHKËPUNIMIN ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË GJATË 2014.

*nga Dëshira HUQI – Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë,
botuar në gazetën “Telegraf”, më 25 shkurt 2015.*

Tashmë është fakt i pakundërshtueshëm se KLSH qysh prej fillim vitit 2012, është kthyer në një aktor aktiv dhe konstant në bashkëpunimet dhe pjesëmarrjet ndërkombëtare në komunitetin e përbashkët EUROSAI dhe INTOSAI duke i dhënë kuptimin e plotë motos së Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve supreme të Auditimit, “Experientia Mutua Omnibus Prodest”.



Z.Jacek Jezierski, ish-President i NIK të Polonisë dhe këshilltar pranë presidentit aktual të këtij institucioni është shprehur se...” *Gjithmonë e kam vlerësuar bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet institucioneve më të larta të auditimit, sepse shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave na lejon të mësojmë nga njëri-tjetri...prandaj ne duhet të shkëmbejmë praktikat më të mira dhe të mësojmë nga gabimet e njëri-tjetrit, duke përmirësuar kështu mënyrën sesi punojmë dhe jemi në shërbim të shoqërive tona...”. Kjo përbën*

pa dyshim një vlerë të shtuar për institucionin dhe i mundëson atij që të zgjerojë më tej njohuritë mbi standartet e auditimit dhe praktikat më të mira, ashtu si edhe të promovojë e shkëmbejë eksperiencat dhe arritjet me organizatat homologe dhe jo vetëm, në të gjithë botën.

Pjesëmarrja e fundit e KLSH-së në punimet e Kongresit të IX të EUROSAT-t të zhvilluar në Hagë, Holandë me tematikë “Inovacionin” dhe të konceptuarit e aktiviteteve të kongresit, bënë që përfaqësuesit e KLSH-së të ishin protagonistë në promovimin e risive domethënëse dhe të pa konceptuara më parë të zhvilluara në institucion, si bashkëpunimi me shoqërinë civile, me organizatat profesionale, prezenca e audituesve të KLSH-së në media, etj. Gjithashtu përfaqësuesit e KLSH-së kanë qenë të pranishëm në zhvillimet e shumë aktiviteteve, seminareve dhe trajnimeve të organizuara mbi tematika të ndryshme si mbi Auditimet IT, një praktikë e re kjo në KLSH, auditimet e mjedisit e të performancës, mbi luftën ndaj korrupsionit, zbatimin e ISSAI-ve mbi auditimet e përputhshmërisë, kuadrit të matshmërisë së performancës, etj. Të gjitha këto, janë eksperiencat të vyera që jo vetëm kanë bërë të mundur pjesëmarrjen e një pjese dërrmuese të audituesve dhe punonjësve të KLSH-së në trajnimet dhe eventet jashtë vendit, por dhe që kanë përçarur raporte e informacione, të cilat KLSH ka dashur të ndajë me partnerët dhe homologët.

Vlen për t’u theksuar bashkëpunimi dhe partneriteti i konsoliduar tashmë me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit pranë Komisionit Europian, DG-Budget, në përgatitjen dhe hartimin e ligjit të ri të KLSH-së. Ky bashkëpunim daton që në vitin 2012 kur me nisëm të Kryetarit të KLSH-së, z. Leskaj janë

organizuar tryeza të përbashkëta diskutimesh me ekspertë dhe akademikë të fushës, shoqërinë civile, palët e interesit, etj dhe ku DG-Budget ka luajtur një rol të rëndësishëm në dhënien e asistencës teknike dhe ligjore. Këto përpjekje u finalizuan me shumë sukses duke u miratuar një ligj i ri për KLSH-në, i cili është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare ISSAI dhe që rregullon në mënyrë përfundimtare pavarësinë e plotë institucionale të KLSH-së duke e kthyer në një institucion modern dhe bashkëkohor auditimi. Mbështetja e DG-Budget shtrihet edhe më gjerë në organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me KLSH-në, si dhe është një prezencë konstante në punimet e Konferencës Shkencore që KLSH organizon tashmë me shumë sukses prej tre vitesh rresht.

Në kuadër të një bashkëpunimi të frytshëm dhe mbështetjeje të vazhdueshme që strukturat e BE-së kanë dhënë për institucionin, si edhe në funksion të objektivit strategjik të ngritjes së kapaciteteve, KLSH aplikoi pranë Delegacionit të BE-së në Tiranë dhe me mbështetjen e tij të plotë përftoi në kuadër të fondeve IPA 2013, Projektin e Binjakëzimit, “Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”. Ky projekt, i cili fillon në muajin maj 2015, fokusohet në tre Komponentë kryesorë: Komponenti i I-rë mbi “Përmirësimet e kuadrit ligjor”, Komponenti i II-të mbi “Zhvillimin e metodologjive të auditimit” dhe Komponenti III-të mbi “Forcimin e kapacitetit institucional të KLSH-së”.

Përftimi i statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian, solli për KLSH-në edhe intensifikimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit konkret me ECA-n, Gjykatën Europiane të Audituesve. Një tjetër vlerë e shtuar kjo

për institucionin ku KLSH përfton nga përvoja më e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze europiane, si dhe shkëmben njohuri dhe praktika nga pjesëmarrja në rrjetin e koordinatorëve të vendeve të SAI-ve anëtare të BE-së, të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE, nga pjesëmarrja në punimet e takimit të Komitetit të Kontaktit dhe nga marsi i vitit 2015, për herë të parë, duke qenë edhe pjesë përbërëse e strukturave të ECA-s nëpërmjet 3 audituesve të KLSH-së, të cilët përftuan nga programet e internshipit të këtij institucioni, të drejtën për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Në kuadër të këtij bashkëpunimi të suksesshëm, z. Vitor Caldeira, President i ECA-s me ftesë të Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar Leskaj, do të zhvillojë vitin e ardhshëm në KLSH një vizitë zyrtare.

KLSH ka vijuar me sukses bashkëpunimin e shkëlqyer me institucionet homologe dhe partnere me të cilat janë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi në fusha të ndryshme me interes të përbashkët, ku në mënyrë të veçantë sesionet e trajnimeve të vazhdueshme të organizuara për audituesit e KLSH-së në Gjykatën Turke të Llogarive dhe NIK të Polonisë, përbëjnë një nga elementet kryesorë të ngritjes profesionale cilësore të audituesve të KLSH-së. E shprehur në shifra, mjafton të thuhet se përgjatë viteve, progresi i arritur në fushën e trajnimeve konsiston jo vetëm në arritjen, po më tepër në tejkalimin e objektivave të vendosur në programet e trajnimeve të KLSH-së. Me këtë performancë lidhet edhe një tregues tjetër, ai i realizimit të afërsisht një muaj trajnimi në secilin prej viteve 2012, 2013, 2014, ku sidomos gjatë dy viteve të fundit, janë trajnuar jashtë vendit çdo vit, rreth 120 auditues. Duke bërë një krahasim të thjeshtë për ditë

trajnimi/punonjës në vit, treguesi është **10 herë më i lartë se gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011** ose **5 fishi i të dy viteve 2010-2011, të marra së bashku**. Në dy vitet e fundit, institucioni ka ndryshuar koncept në investimin për kapacitetet audituese. Nga një institucion i disa viteve më parë praktikisht pa trajnim, është kthyer në SAI-in me tregues perëndimorë trajnimi.

SIGMA, një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së përbën një ndihmesë të vyer në punën që KLSH bën në procesin e ngritjes profesionale nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe asistencës për zbatimin e projekteve dhe planeve të punës nëpërmjet këshillimeve, asistencës teknike, përshtatjes dhe njohjes së standarteve të auditimit dhe praktikave më të mira europiane. Një falënderim i veçantë shkon për z. Joop Vrolijk, Këshilltar i lartë pranë SIGMA-s, i cili ka dhënë një ndihmesë të çmuar dhe mbështetje të vazhdueshme për KLSH-në gjatë dy viteve të fundit, sidomos për rritjen e kapaciteteve të audituesve të institucionit. Për këtë qëllim, në dhjetor 2013, Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani i akordoi z. Vrolijk “Medaljen e Mirënjohjes”, *“Për kontributin dhe ndihmesën e çmuar në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

IDI (Iniciativa e INTOSAI-t për Zhvillim) është një nga strukturat e tjera ndërkombëtare me të cilat KLSH ka zhvilluar një marrëdhënie të vazhdueshme nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe të suksesshme në programet e trajnimit që IDI ofron. Qëllimi i IDI-t është përmirësimi i kapaciteteve audituese dhe adresimi efektiv i çështjeve emergjente të auditimit nëpërmjet trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit. Audituesit e

KLSH-së kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar nga programet rajonale të ndërmarra nga IDI për auditimet financiare dhe të performancës, për borxhin publik dhe së fundi me shumë sukses po ndiqen dy programet mbi ngritjen e kapaciteteve. Së pari, Inisiativa për zbatimin e standarteve ndërkombëtare të auditimit ISSAI, Programi 3i, i cili përputhet plotësisht edhe me punën voluminoze që KLSH bën në dhënien e informacionit mbi ISSAI-t dhe përditësimin e tyre dhe së dyti, Programi më i fundit për Auditimin IT.

Si fryt i këtij bashkëpunimi të suksesshëm dhe intensiv me partnerët dhe homologët tanë, vjen tashmë prej tre vitesh edhe organizimi e zhvillimi i Konferencave Vjetore Shkencore të KLSH-së, praktikë kjo e pa konceptuar tre vite më parë. Konferenca numëron përkrah pjesëmarrësve vendas edhe shumë përfaqësues të SAI-ve homologe të Polonisë, Austrisë, Kroacisë, Turqisë, Kosovës, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, etj përfaqësues nga Parlamenti Europian, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Europian, DG-Budget dhe përfaqësitë diplomatike në Shqipëri.



Në respekt dhe përputhje të plotë me parimet e bashkëpunimit të organizatave ndërkombëtare, të standardeve të INTOSAI-t, si dhe të Planit Strategjik të KLSH-së 2013-2017, ashtu siç është theksuar edhe në projekt-idenë e drejtimit të KLSH-së nga kandidati i nominuar për kryetar, z. Bujar Leskaj (tashmë Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit që prej fund vitit 2011)...”*Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e Komisionit të BE dhe SIGMA-n, me Institucionet e larta të kontrollit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës...dhe ...”* Vendorsja e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë”, thellimi i bashkëpunimit me partnerët dhe homologët tanë, do të vijojë të jetë një nga pikat kyçe të punës që KLSH ndërmerr për ngritjen dhe thellimin e profesionalizmit si dhe të modernizimit të mëtejshëm institucional, në arritje të praktikave dhe standardeve më të mira për një shërbim më cilësor ndaj qytetarëve, grupeve të interesit dhe mirëqeverisjes në përgjithësi.